

Teknika kirurgjike
aneXys



Për përdorim vetëm nga profesionistët e shëndetësisë. Imazhi i ilustruar nuk pasqyron një lidhje midis përdorimit të pajisjes mjekësore të përshkruar apo performancës së saj.

Preservation in motion

*Të mbështesim trashëgiminë tonë
Të çojmë teknologjinë përpara
Hap pas hapi me partnerët tanë klinikë
Drejt një qëllimi për të ruajtur lëvizshmërinë*

Preservation in motion

Duke qenë një kompani zvicerane, Mathys i është përkushtuar këtij parimi udhëheqës dhe zhvillon një portofol produktesh me qëllim zhvillimin e mëtejshëm të filozofive tradicionale lidhur me materialet ose dizajnin për të adresuar sfidat ekzistuese klinike. Kjo pasqyrohet në imazhet tona: aktivitete tradicionale zvicerane në lidhje me zhvillimin e vazhdueshëm të pajisjeve sportive.

Tabela e përmbajtjes

Parathënie	4
1. Indikacionet dhe kundërindikacionet	6
2. Planifikimi para operacionit	8
3. Teknika kirurgjike	12
4. Implantet	21
5. Instruments	27
5.1 Kompleti i instrumenteve aneXys	27
5.2 Shablloni matës	38
6. Referencat	38
7. Simbolet	39

Vërejtje

Para se të përdorni një implant të prodhuar nga Mathys Ltd Bettlach, familjarizohuni me përdorimin e instrumenteve, teknikat kirurgjike dhe paralajmërimet që lidhen me produktet, shënimet e sigurisë, si dhe rekomandimet e fletës së udhëzimeve. Përdorni trajnimin e Mathys për përdoruesit dhe vazhdoni sipas teknikës së rekomanduar kirurgjike.

Parathënie

Sot, implantimi i nyjave artificiale të këllkut është një prej procedurave standarde më të suksesshme në kirurgji.¹ Qëllimi i zëvendësimit të nyjës është eliminimi i dhimbjes, rikthimi i funksionit dhe rindërtimi i anatomisë fiziologjike të nyjës së këllkut. Për shkak të zhvillimit demografik dhe shtimit të rëndësisë së sporteve edhe në moshë të përparuar, numri i këtyre operacioneve mund të pritët që të rritet.²

Përmirësimi i cilësisë së jetesës së pacientëve të çdo moshe ka qenë një prej parimeve kryesore të Mathys që prej vitit 1963. Kërkimet në fushën e materialeve të implanteve dhe përmirësimi i tyre, optimizimi i ndërtimit të protezave dhe përmirësimi i përdorimit të instrumenteve bëjnë të mundur që Mathys t'i përmbushë këto kërkesa. Ne e konsiderojmë si detyrën tonë kryesore përballimin me sukses të kësaj sfide. Eksperienca shumëvjeçare e Mathys në këto fusha kryesore të aktivitetit tonë janë themeli i suksesit të projekteve tona.

Sipërfaqja e kupës aneXys është makrostrukurore dhe ka një shtresë poroze shtesë. Kupa modulare aneXys ofron një gamë të gjerë komponentësh me opsione të ndryshme tribologjike.


Instrumentet i japin mundësi kirurgut ta implantojë sistemin nëpërmjet metodave të ndryshme kirurgjike.



Me polietilenin (vitamys) me rrjetëzim të lartë dhe të pasuruar me vitaminë E si dhe me materialin kompozit të përparuar prej qeramike për artikulacionin (ceramys) qeramikë mbi qeramikë, gama jonë e produkteve përfshin disa opsione të përmirësuara për mbështetjen.

vitamys pengon vjetrimin e parakohshëm të materialit^{3*} duke kontribuar në këtë mënyrë në stabilitetin afatgjatë të ankorimit të implantit. Në krahasim me polietilenin tradicional, vitamys lejon gjithashtu përdorimin e kokave me diametër më të madh, deri në 36 mm, për stabilitetin më të madh të nyjës dhe për përmirësimin e funksionit.⁴

ceramys është një qeramikë me përhapje nanokristaline në zirkon të përforcuar me oksid alumini (Alumina Toughened Zirconia, ATZ). Ajo ofron një rezistencë të lartë ndaj thyerjes, është shumë rezistente ndaj vjetërimit⁵ dhe shfaq norma të ulëta konsumimi për artikulacionin qeramikë mbi qeramikë.^{6,7}



* Në bazë të të dhënave të bankëprovës paraklinike

1. Indikacionet dhe kundërindikacionet

1.1 Indikacionet

- Osteoartriti parësor ose dytësor i këllkut
- Frakturat e kokës femorale dhe qafës femorale
- Nekroza e kokës femorale

Inlay aneXys ceramys:

- Artroplastika totale e këllkut e kombinuar me folenë aneXys Cluster, aneXys Uno ose aneXys Multi, që synohet të përdoret me një inlay qeramik

Kombinimi i folesë aneXys – inlay-it – kokës:

Inlay-et ceramys mund të përdoren vetëm të kombinuara me foletë aneXys në vijim: Uno, Cluster, Multi.

Inlay-et vitamys mund të përdoren me të gjitha llojet e foleve aneXys.

Foleja	Inlay vitamys	Inlay ceramys
aneXys Flex	✓	--
aneXys Uno	✓	✓
aneXys Cluster	✓	✓
aneXys Multi	✓	✓

Inlay-et ceramys mund të përdoren vetëm të kombinuara me kokat femorale qeramike të Mathys.

1.2 Kundërindikacionet

- Prania e faktorëve që rrezikojnë ankorimin e fiksuar të implantit:
 - Humbja e kockës dhe/ose defektet e kockës
 - Substanca e pamjaftueshme kockore
- Prania e faktorëve që pengojnë oseointegrimin:
 - Kocka e rrezatuar (përgjatim: rrezatimi para operacionit për profilaksinë e osifikimit)
 - Devaskularizimi
- Infeksioni lokal dhe/ose i përgjithshëm
- Mbindjeshmëria ndaj cilitdo prej materialeve të përdorura
- SPamjaftueshmëria e rëndë e indit të butë, nervave ose enëve të gjakut që rrezikon funksionin dhe qëndrueshmërinë afatgjatë të implantit
- Pacientët tek të cilët ka mundësi të jetë i suksesshëm një lloj tjetër operacioni rindërtues ose trajtimi

Inlay aneXys ceramys:

- Artroplastika totale e këllkut me një kupë që nuk synohet të përdoret me inlay-in qeramik aneXys
- Kirurgjia korrigjuese me folenë të lënë në vend
- Inlay qeramik i kombinuar me një kokë metalike
- Inlay qeramik i kombinuar me një kokë qeramike nga cilido prodhues i ndryshëm nga Mathys Ltd Bettlach
- Mos i përdorni çiftet ku të dy komponentët janë të fortë për kupat me pjerrësi nën 40° ose mbi 50° si, për shembull, në trajtimin e displazisë, meqenëse implantet mund të dëmtohen nga proceset e nënluksacionit ose nga pikat e kontaktit midis komponentëve
- Mos implantoni një çift ku të dy komponentët janë të fortë nëse ka rrezik shtypjeje midis bishtit të këllkut dhe kupës. Në këtë rast përdorni një çift me njërin komponent të fortë dhe tjetrin të butë

Për informacione të mëtejshme, shikoni udhëzimet për përdorimin ose pyesni përfaqësuesin tuaj të Mathys.

2. Planifikimi para operacionit

Përcaktimi i masës nëpërmjet një shablloni para operacionit mund të kryhet në radiografi të standarde ose me një sistem dixhital planifikimi. Qëllimi kryesor i planifikimit është përcaktimi i implantit të përshtatshëm, i masës dhe pozicionit të tij me qëllim restaurimin e biomekanikës individuale të njëjës së këllkut. Në këtë mënyrë, problemet e mundshme mund të identifikohen që përpara ndërhyrjes kirurgjike.⁸

Gjithashtu, planifikimi para operacionit shërben si bazë për përputhjen gjatë operacionit duke përdorur kontrollin fluoroskopik.

Rekomandohet dokumentimi i planifikimit para operacionit në dosjen e pacientit.




Fig. 1

Planifikimi kryhet në mënyrë ideale në një radiografi të legenit, e cila bëhet me pacientin në pozicionin në këmbë ose shtrirë në shpinë. Duke vepruar kështu, rrezja qendrore drejtvendoset me simfizën me femurët të rrotulluar 20 gradë nga brenda. Shkalla llogaritet me opsionet e njohura, të cilat janë ose me një objekt të përcaktuar matës, ose duke përdorur një distancë të njohur dhe të rikrijueshme të filmit me fokusin (Fig. 1).

Vërejtje

Në rastin e këllqeve shumë të deformuara, duhet marrë parasysh planifikimi në anën e shëndetshme, në mënyrë që të transferohet më pas në anën e prekur.⁸




Fig. 2

Përlllogaritja e zhvendosjes së acetabulit nga boshti

Qendrat e rrotullimit të këllkut të shëndetshëm (A) dhe atij të prekur (A') përcaktohen secila si qendra e një rrethi që rrethon kokën femorale ose kavitetin e acetabulit.

Në fillim vendoset një vijë horizontale si tangjente në të dyja tuberozitetet iskiatike dhe një vijë e dytë pingule vendoset nëpër qendrën e simfizës.

Vërejtje

Në rastin e balancimit të gjatësisë së këmbës, tashmë mund të merret parasysh përshtatja e gjatësisë së këmbës me ndihmën e tuberozitetit iskiatik.

Zhvendosja e acetabulit nga boshti përcaktohet si distanca midis pikës së lotit të Köhler-it (B ose B') dhe vijës vertikale nëpër qendrën e rrotullimit të këllkut (A ose A') (Fig. 2).




Fig. 3




Fig. 4




Fig. 5

Planifikimi i kupës

Pozicioni i kupës në lidhje me legenin duhet të marrë parasysh konturet acetabulare, qendrën e rrotullimit të këllkut, pikën e lotit të Köhler-it dhe këndin e nevojshëm të pjerrësisë së kupës (Fig. 3).

Për të gjetur masën e përshtatshme të kupës, disa shabllone të kupës pozicionohen njëri pas tjetrit në nivelin e kavitetit të acetabulit me qëllim rikthimin e qendrës origjinale të rrotullimit të këllkut dhe duke mundësuar njëkohësisht kontaktin e mjaftueshëm të kockës në nivelin e kubesë së acetabulit si dhe në atë të pikës së lotit të Köhler-it (Fig. 4).

Në pozicionimin e kupës, duhet marrë parasysh anatomia individuale e pacientit. Pozicioni i implantit përcaktohet në lidhje me pikat anatomike të referimit (kubaja e acetabulit, pika e lotit të Köhler-it). Më pas përcaktohet thellësia e implantimit (Fig. 5).




Fig. 6

Përlogaritja e zhvendosjes së femurit nga boshti

Zhvendosja e femurit nga boshti përcaktohet si distanca më e vogël midis boshtit gjatësor qendror të femurit dhe qendrës së rrotullimit të këllkut (Fig. 6).

Vërejtje

Planifikimi i bishtit tregohet duke përdorur bishtin twinSys si shembull. Mund të përdoren edhe sistemet e tjera të bishtit.




Fig. 7

Planifikimi i bishtit

Përcaktimi i masës së bishtit me anë të shablloneve matëse në femurin që do të operohet. Shablloni duhet të vendoset në vijë të drejtë me qendrën e rrotullimit dhe boshtin qendror të femurit (Fig. 7).




Fig. 8

Në fletën e planifikimit, bishti që përputhet paraqitet në formën e vijave me ndërprerje me shabllonin matës në të njëjtin pozicion abduksion / aduksioni me femurin e anës së shëndetshme (Fig. 8).




Fig. 9

Femuri që do të operohet skicohet mbi bishtin e zgjedhur. Për kontrollin gjatë operacionit, matet distanca midis fundit proksimal të konit të bishtit dhe trokanterit më të vogël, si dhe distanca midis shpatullës së bishtit dhe trokanterit të madh.

Hartimi i planit të rezekimit dhe përcaktimi i ndërprerjes midis masës trokanterike dhe vijës ndarëse laterale të bishtit të protezës (Fig. 9).

3. Teknika kirurgjike

Kupa aneXys mund të implantohet duke përdorur disa metoda kirurgjike dhe pozicionime të pacientit. Vendimi për të përdorur një teknikë specifike duhet të bazohet në anatominë e pacientit, në ndërhyrjen kirurgjike të planifikuar dhe në eksperiencën dhe preferencat personale të kirurgut.



Fig. 10

Osteotomia femorale

Qafa e femurit rezektohet sipas planifikimit para operacionit (Fig. 10). Në rastin e kushteve anatomike të vështira, është e këshillueshme të kryhet një osteotomi e dyfishtë dhe të hiqet një fragment i qafës së femurit. Më pas, koka e femurit hiqet me një ekstraktor të kokës së femurit.




Fig. 11

Përgatitja e acetabulit

Ekspozimi i mjaftueshëm i acetabulit është i domosdoshëm për përgatitjen pa rrezik të acetabulit për të garantuar implantimin e saktë të kupës dhe stabilitet të mirë primar. Duke përdorur frezat acetabulare sferike me masa në zbritje, shtrati i acetabulit përpunohet me faza rritjeje prej 2 mm secila, derisa të arrihet thellësia dhe masa e saktë. Kocka subkondrale me sklerozë përgatitet në një mënyrë të tillë që të ketë sa më pak hemorragji (Fig. 11).

Vërejtje

Sigurohuni që acetabuli të frezohet deri në gjatësinë e implantit që është përcaktuar në planifikimin para operacionit. Për ankorimin e sigurt nëpërmjet vendosjes me presim, acetabuli duhet të frezohet në formë sa më hemisferike të jetë e mundur.

Pastrimi i kujdesshëm i harkut acetabular është i rëndësishëm për të shmangur futjen e indeve të buta midis kockës dhe kupës gjatë implantimit.

Freza acetabulare 52



Kupa e provës 52



Foleja aneXys 52



Fig. 12



Fig. 13




Fig. 14

Implantimi i folesë prej titani

Me anë të kupës së provës, kontrolloni rrumbullakësinë e acetabulit të frezuar si dhe harmoninë e shtratit të frezuar të implantit, gjatësinë e implantit dhe stabilitetin e masës së zgjedhur të kupës.

Kupa e provës është 0,5 mm më e madhe sesa freza acetabulare, ndërsa implanti përfundimtar e ka madhësinë ekuatoriale afërsisht 1,5 mm më të madhe (Fig. 12).

Përcaktimi i masës së implantit përfundimtar përputhet me masën e frezës që është përdorur e fundit.

Kupa e provës montohet në impaktorin e folesë duke përdorur kaçavidën (Fig. 13) dhe ngulet në acetabul (Fig. 14).

Vërejtje

Kur përdorni impaktorin e drejtë të folesë, ai vidhohet drejt e në vrimën polare të kupës së provës.

Nga hapësirat e shikimit të kupës së provës, mund të llogaritet thellësia dhe rrumbullakësia e acetabulit të frezuar. Është e rëndësishme që të siguroni mbulim të mjaftueshëm kockor të folesë.

Vërejtje

Rekomandohet që implanti përfundimtar të zgjidhet vetëm kur kupa e provës të ketë zënë vend mirë. Vendosja e stabilizuar e kupës së provës arrihet kur legen i pacientit mund të lëvizet duke anuar lehtë impaktorin e folesë.

Përtej këtij animi këndor, kupa e provës duhet të hiqet me lehtësi nga acetabuli.




Fig. 15

Pozicioni i shtrirë në shpinë – pamje laterale




Fig. 16

Pozicioni i shtrirë në shpinë – pamje nga lart

Për implantimin e folesë aneXys, montoni implantin analog me kupën e provës në impaktorin e folesë.

Vërejtje

Për të shmangur dëmtimin e implanteve dhe instrumenteve, duhet të kontrolloni nëse foleja aneXys ka zënë vend mirë në impaktorin e folesë.

Udhëzuesi i pozicionimit përdoret si mjet ndihmës për pozicionimin për të përcaktuar pjerrësinë dhe anteversionin e dëshiruar të implantit.

Udhëzuesi i pozicionimit montohet në dorezën e impaktorit të drejtë ose të lakuar të folesë. Te pacientët në pozicionin e shtrirë në shpinë, udhëzuesi i pozicionimit tregon një pjerrësi 40°–45° dhe anteversion 15° (Fig. 15, 16). Te pacientët në pozicionin e shtrirë në anë, udhëzuesi i pozicionimit tregon një pjerrësi 40° dhe anteversion 15°–20° (Fig. 17, 18).

Vërejtje

Rregullimi i saktë i pjerrësisë dhe anteversionit është i domosdoshëm për funksionimin pa ndërlikime të njëjës artificiale të këllkut; këtu duhet të merret parasysh anatomia individuale. Në përgjithësi rekomandohet një pjerrësi 40°–50° dhe një anteversion 10°–20°.

Vërejtje

Në mënyrë opsionale, pllaka për rrotullim dhe ekstraktim mund të montohet në dorezën e impaktorit të folesë dhe të përdoret për pozicionimin e kontrolluar të folesë.

Kur të implantohet foleja, duhet të sigurohet orientimi i saktë i vrimave të vidhave. Vrimat duhet të vendosen në sektorin e sipërm të pasmë (a) ose në sektorin e poshtëm të pasmë (b) të acetabulit (Fig. 21).⁹ Për orientimin, foletë me vrima për vidhat kanë një shenjë në formë shigjete që e ka zakonisht drejtimin nga gryka acetabulare. Fiksimi shtesë me vidha përshkruhet në faqen 16.




Fig. 17 Pozicioni lateral – pamje laterale




Fig. 18 Pozicioni lateral – pamje nga lart



Fig. 19

Foleja është ngulitur në pozicionin përfundimtar të përcaktuar në planifikimin para operacionit.

Vërejtje

Për kontrollin e stabilitetit pas implantimit, impaktori i folesë mund të anohet lehtë derisa legëni i pacientit të mund të lëvizet.

Rekomandohet verifikimi i pozicionit të kupës gjatë operacionit me konvertuesin e imazhit.¹⁰

Nëse kupa nuk është e stabilizuar sa duhet, mund të merret parasysh një frezim pak më i thellë me frezën me masën e përdorur herën e fundit nëse ka rezervë të mjaftueshme kocke.

Pas heqjes së impaktorit të folesë, vrima polare qendrore mbyllet në mënyrë opsionale me një kësulë polare. Ajo pozicionohet në kaçavidë ose në vendosësin e lakuar të tapës polare dhe shtrëngohet me dorë (Fig. 19).



Duhet të siguroheni që kësula polare të jetë vidhosur krejtësisht dhe të mos zgjatet më brenda folesë. Shmangni shtrëngimin e tepërt të kësulës polare.

Vërejtje

Kësula polare përfshihet tashmë në paketimin e foleve aneXys pa vrima për vidhat (aneXys Flex, aneXys Uno). Për foletë me vrima për vidhat (aneXys Cluster, aneXys Multi), kësula polare disponohet veçan si një artikull i vetëm steril.



Fig. 20

Fiksimi shtesë me vidha

Në mënyrë opsionale, foletë aneXys Cluster dhe Multi mund të fiksohen me vidha të kockës sfungjore. Për këtë qëllim, vrimat e vidhave shpohen paraprakisht me një bosht të përkulshëm, një punto 3,2mm dhe me udhëzuesin e shpimit (Fig. 20).




Fig. 21



Për të minimizuar rrezikun e dëmtimit të nervave dhe enëve të gjakut, pozicioni dhe thellësia e shpimit të vrimave të vidhave si dhe gjatësitë përkatëse të vidhave duhet të zgjidhen duke marrë parasysh anatominë e zonës së legenit të pacientit.

Vidhat preferohet të vendosen në sektorin e sipërm të pasmë (a) ose, duke treguar kujdes, në sektorin e poshtëm të pasmë (b) të acetabulit (Fig. 21).⁹ Kupa dhe, si rrjedhim pozicioni i vrimave të shpuara paraprakisht, duhet të vendosen në përputhje me to.




Fig. 22

Pas përcaktimit të gjatësisë së nevojshme të vidhave me matësin e thellësisë, një forceps për mbajtjen e vidhave dhe një kaçavidë heksagonale me kadran e lehtësojnë implantimin e vidhave vetëfiletuese të kockës sfungjore aneXys (Fig. 22).

Vërejtje

Mund të përdoren vetëm vidhat e kockës sfungjore aneXys.



Në mënyrë që të mos ndërhyjnë në ankorimin e inlay-it, duhet treguar kujdes gjatë futjes së vidhave të kockës sfungjore, në mënyrë që kokat e vidhave të jenë futur deri në fund në vrimat e vidhave të folesë.




Fig. 23

Reduktimi provë me inlay-et e provës

Kanali femoral përgatitet sipas teknikës kirurgjike për bishtin. Inlay i provës që i korrespondon implantit të dëshiruar (shikoni tabelën) pozicionohet me dorë në fole (Fig. 23).

Inlay	Inlay i provës standard	Inlay i provës i ngritur
Inlay vitamys standard	✓	--
Inlay vitamys i ngritur	--	✓
Inlay ceramys	✓	--



Foletë aneXys kanë të shënuar në etiketë diametrin e jashtëm dhe një kod me një shkronjë (p. sh. 52/H). Inlay-et korresponduese të provës janë shënuar me diametrin e kokës dhe kodin përkatës me një shkronjë (p. sh. 32/H). Kodet me një shkronjë të dy komponentëve duhet të përputhen.

Pas përgatitjes së kanalit femoral, nyja reduktohet me limë ose me implantin përfundimtar të bishtit në vend dhe një kokë prove që përshtatet me diametrin e brendshëm të kupës. Pas reduktimit provë, nyja e këllkut lëvizet në të gjithë gamën e saj të lëvizjes.

Gjatë këtij veprimi, duhet treguar kujdes ndaj indit të butë dhe shtypjes së qafës me kupën si dhe vlerësohet tendenca për luksacion e implantit gjatë rrotullimit të brendshëm/të jashtëm në përkulje dhe shtrirje. Përveç

kësaj, duhet siguruar presioni i mjaftueshëm mbi indin e butë.

Në këtë moment, është ende e mundur të modifikohet gjatësia e qafës së kokës dhe varianti i bishtit standard/lateral).

Mund të bëhet edhe një radiografi tjetër gjatë operacionit, duke përdorur konvertuesin e imazhit, për një kontroll të fundit.

Vërejtje

Implantimi i bishtit dhe përcaktimi i kokës së përshtatshme sferike përshkruhen në një teknikë kirurgjike të veçantë. Ajo mund të kërkohet nga agjencia lokale Mathys.

Vërejtje

Mos implantoni një çift ku të dy komponentët janë të fortë nëse ka rrezik shtypjeje midis bishtit të këllkut dhe kupës. Në këtë rast, përdorni një çift me njërin komponent të fortë dhe tjetrin të butë.

Pas kësaj, inlay i provës hiqet duke përdorur pincat e dhëna për këtë qëllim.




Fig. 24




Fig. 25




Fig. 26

Vendosja e inlay-it aneXys



Për të shmangur ndërlikimet në ndërfaqen midis inlay-it dhe folesë, duhet të tregohet kujdes në mënyrë që koni i brendshëm i folesë të jetë i thatë dhe pa copëza të huaja para montimit të inlay-it përfundimtar.



Kodi me shkronjë në fole dhe në inlay duhet të jetë i njëjtë.

Futni me dorë inlay-in aneXys në fole dhe qendërzojeni (Fig. 24).



Kombinimi i folesë aneXys – inlay-it – kokës:

Inlay-et ceramics mund të përdoren vetëm të kombinuara me fole të aneXys në vijim: Uno, Cluster, Multi.

Inlay-et vitamys mund të përdoren me të gjitha llojet e foleve aneXys.

Foleja	Inlay vitamys	Inlay ceramics
aneXys Flex	✓	--
aneXys Uno	✓	✓
aneXys Cluster	✓	✓
aneXys Multi	✓	✓

Inlay-et ceramics mund të përdoren vetëm të kombinuara me kokat femorale qeramike të Mathys.

Koka prej poliamidi me diametrin e saktë vidhohet në impaktorin e folesë dhe inlay fiksohet në fole duke goditur me çekiç impaktorin e folesë (Fig. 25).

Vërejtje

Gjatë pozicionimit të tij, duhet të siguroheni që inlay të mos jetë i anuar.

Në pozicionin përfundimtar pas nguljes, inlay është rrafsh me buzën e folesë. Vendosja e duhur e inlay-it sigurohet duke lëvizur majën e gishtit rreth buzës së folesë (Fig. 26).

Pas implantimit të bishtit dhe kokës sferike që përshtatet me diametrin e artikulacionit të kupës, duhet të tregoni kujdes që hapësira e nyjës të mos ketë copëza të huaja në kohën e reduktimit.

Në varësi të metodës, futjet e muskujve ribashkohen pas reduktimit të nyjës dhe plaga mbyllet shtresë pas shtrese.

Informacione të tjera: Inlay qeramik



Në rastin e dhimbjes së vazhdueshme, traumës ose shfaqjes së ndonjë zhurme (p. sh. gërvima, klikime), duhet të bëhet një sqarim i saktë i problemit ose i shkakut për çiftet qeramike mbi qeramike.



Inlay-et qeramike (ceramys) lejohen të përdoren vetëm të kombinuara me kokat femorale qeramike të Mathys.

Vërejtje

Gjatë implantimit të inlay-it qeramik, duhet kontrolluar gama e lëvizjes dhe stabiliteti me anë të komponentëve të provës për të shmangur ciflosjen e harkut ose thyerjen pas operacionit të komponentëve të implantit. Është e nevojshme të kaloni në një inlay (vitamys) prej polietileni me rrjetëzim të lartë nëse ekziston rreziku i shtypjes.

Në foletë e reja aneXys, përdorni vetëm inlay-e qeramike. Nëse në fole ishte ngulur një inlay tjetër, nuk mund të përdoret një inlay qeramik. Në këto raste, duhet të përdoret një inlay (vitamys) prej polietileni me rrjetëzim të lartë ose kupa duhet të korrigjohet krejtësisht.



Fig. 27




Fig. 28

Heqja e inlay-it qeramik

Inlay qeramik mund të hiqet me pjesët e veçanta ndihmëse për impaktorin e kupës.

a) Ekstraktori universal

Ekstraktori universal vidhoset në impaktorin e folesë.



Është e rëndësishme që ekstraktori të vendoset pikërisht mbi buzën e folesë aneXys (Fig. 27) me një kënd minimal prej 90°. Ekstraktori nuk duhet të ketë asnjë kontakt me inlay-in qeramik.

Inlay shkëputet nga foleja me anë të disa goditjeve me çekiç (Fig. 28).



Fig. 29




Fig. 30



Fig. 31

b) Instrumenti për heqjen e inlay-it qeramik

Vidhosni majën për heqje me masën përkatëse të inlay-it qeramik në impaktorin e folesë. Më pas, në majën për heqje vidhosni kokën për heqje me diametrin e saktë (Fig. 29).

Vendoseni instrumentin pikërisht mbi buzën e folesë metalike dhe shkëputeni inlay-in me disa goditje të çekiçit (Fig. 30).

Vërejtje

Duhet të kontrolloni gjithmonë stabilitetin e kupës pasi të keni hequr inlay-in.



Ndalohet ripërdorimi i inlay-it qeramik që është hequr.

Në rastin e thyerjes së njërit prej komponentëve prej qeramike ose e të dyve, nuk indikohet përdorimi i një koke prej metali.

Heqja e inlay-it prej polietileni

Përdorni një punto 3,2 ose 3,5 mm për të shpuar një vrimë provë në inlay-in prej polietileni. Shmangni shpimin mbi kësulën polare, mbi një vidhë ose mbi një vrimë vidhe.

Vendosni një vidhë jovetëfiletuese 6,5 mm në vrimën e shpuar (Fig. 31) dhe shtrëngojeni me një kaçavidë për ta nxjerrë duke e ngritur inlay-in prej polietileni jashtë folesë.¹¹ Në rastin e një këmbimi të një inlay të izoluar, sigurohuni që të mos dëmtoni konin në sipërfaqen e brendshme të kupës.

Vërejtje

Mos përdorni vidha vetëfiletuese për heqjen e inlay-it.

Heqja e kupës aneXys

Para heqjes së kupës, sigurohuni që harku acetabular të jetë ekspozuar plotësisht.

Hiqni kësulën polare dhe vidhat e kockës sfungjerore nëse janë të pranishme.

Përdorni me kujdes osteotome të lakuara ose kompletet universale të instrumenteve për heqjen e kupës për të shkëputur implantin nga kocka derisa të mund të ekstraktohet kupa.

Për informacione të tjera rreth kompleteve universale të instrumenteve për heqjen e kupës, kontaktoni me përfaqësuesin lokal të Mathys.

4. Implantet



Foleja aneXys Flex*

Foleja aneXys Uno, Cluster, Multi

Madhësia e folesë	22,2 mm Di brendshëm	28 mm Di brendshëm	32 mm Di brendshëm	36 mm Di brendshëm	22,2 mm Di brendshëm	28 mm Di brendshëm	32 mm Di brendshëm	36 mm Di brendshëm
40 mm	X				X*			
42 mm	X	X			X*			
44 mm		X			X*	X		
46 mm		X	X			X		
48 mm		X	X			X*	X	
50 mm		X	X	X		X*	X	
52 mm		X	X	X		X*	X	X
54 mm		X	X	X		X*	X	X
56 mm			X	X		X*	X	X
58 mm			X	X			X	X
60 mm			X	X			X	X
62 mm			X	X			X	X
64 mm							X	X
66 mm							X	X
68 mm							X	X
70 mm							X	X

* Për përdorim vetëm me inlay-e vitamys



Foleja aneXys Flex

Nr. i artikullit	Përshkrimi
52.34.0978	Fole aneXys Flex 40 / B
52.34.0979	Fole aneXys Flex 42 / C
52.34.0980	Fole aneXys Flex 44 / D
52.34.0981	Fole aneXys Flex 46 / E
52.34.0982	Fole aneXys Flex 48 / F
52.34.0983	Fole aneXys Flex 50 / G
52.34.0984	Fole aneXys Flex 52 / H
52.34.0985	Fole aneXys Flex 54 / I
52.34.0986	Fole aneXys Flex 56 / J
52.34.0987	Fole aneXys Flex 58 / K
52.34.0988	Fole aneXys Flex 60 / L
52.34.0989	Fole aneXys Flex 62 / M

Materiali: Ti6Al4V, TiCP



Foleja aneXys Uno

Nr. i artikullit	Përshkrimi
52.34.0990	Fole aneXys Uno 40 / A
52.34.0991	Fole aneXys Uno 42 / B
52.34.0992	Fole aneXys Uno 44 / C
52.34.0993	Fole aneXys Uno 46 / D
52.34.0994	Fole aneXys Uno 48 / E
52.34.0995	Fole aneXys Uno 50 / F
52.34.0996	Fole aneXys Uno 52 / G
52.34.0997	Fole aneXys Uno 54 / H
52.34.0998	Fole aneXys Uno 56 / I
52.34.0999	Fole aneXys Uno 58 / J
52.34.1000	Fole aneXys Uno 60 / J
52.34.1001	Fole aneXys Uno 62 / J
52.34.1002	Fole aneXys Uno 64 / K
52.34.1003	Fole aneXys Uno 66 / K
52.34.1004	Fole aneXys Uno 68 / K
52.34.1005	Fole aneXys Uno 70 / K

Materiali: Ti6Al4V, TiCP



Foleja aneXys Cluster

Nr. i artikullit	Përshkrimi
52.34.1006	Fole aneXys Cluster 40 / A
52.34.1007	Fole aneXys Cluster 42 / B
52.34.1008	Fole aneXys Cluster 44 / C
52.34.1009	Fole aneXys Cluster 46 / D
52.34.1010	Fole aneXys Cluster 48 / E
52.34.1011	Fole aneXys Cluster 50 / F
52.34.1012	Fole aneXys Cluster 52 / G
52.34.1013	Fole aneXys Cluster 54 / H
52.34.1014	Fole aneXys Cluster 56 / I
52.34.1015	Fole aneXys Cluster 58 / J
52.34.1016	Fole aneXys Cluster 60 / J
52.34.1017	Fole aneXys Cluster 62 / J
52.34.1018	Fole aneXys Cluster 64 / K
52.34.1019	Fole aneXys Cluster 66 / K
52.34.1020	Fole aneXys Cluster 68 / K
52.34.1021	Fole aneXys Cluster 70 / K

Materiali: Ti6Al4V, TiCP



Foleja aneXys Multi

Nr. i artikullit	Përshkrimi
52.34.1022	Fole aneXys Multi 40 / A
52.34.1023	Fole aneXys Multi 42 / B
52.34.1024	Fole aneXys Multi 44 / C
52.34.1025	Fole aneXys Multi 46 / D
52.34.1026	Fole aneXys Multi 48 / E
52.34.1027	Fole aneXys Multi 50 / F
52.34.1028	Fole aneXys Multi 52 / G
52.34.1029	Fole aneXys Multi 54 / H
52.34.1030	Fole aneXys Multi 56 / I
52.34.1031	Fole aneXys Multi 58 / J
52.34.1032	Fole aneXys Multi 60 / J
52.34.1033	Fole aneXys Multi 62 / J
52.34.1034	Fole aneXys Multi 64 / K
52.34.1035	Fole aneXys Multi 66 / K
52.34.1036	Fole aneXys Multi 68 / K
52.34.1037	Fole aneXys Multi 70 / K

Materiali: Ti6Al4V, TiCP



Inlay aneXys vitamys standard

Nr. i artikullit	Përshkrimi
52.34.1039	Inlay aneXys vitamys standard 22,2 / A
52.34.1040	Inlay aneXys vitamys standard 22,2 / B
52.34.1041	Inlay aneXys vitamys standard 22,2 / C
52.34.1042	Inlay aneXys vitamys standard 28 / C
52.34.1043	Inlay aneXys vitamys standard 28 / D
52.34.1044	Inlay aneXys vitamys standard 28 / E
52.34.1045	Inlay aneXys vitamys standard 28 / F
52.34.1046	Inlay aneXys vitamys standard 28 / G
52.34.1047	Inlay aneXys vitamys standard 28 / H
52.34.1048	Inlay aneXys vitamys standard 28 / I
52.34.1049	Inlay aneXys vitamys standard 32 / E
52.34.1050	Inlay aneXys vitamys standard 32 / F
52.34.1051	Inlay aneXys vitamys standard 32 / G
52.34.1052	Inlay aneXys vitamys standard 32 / H
52.34.1053	Inlay aneXys vitamys standard 32 / I
52.34.1054	Inlay aneXys vitamys standard 32 / J
52.34.1055	Inlay aneXys vitamys standard 32 / K
52.34.1056	Inlay aneXys vitamys standard 32 / L
52.34.1057	Inlay aneXys vitamys standard 32 / M
52.34.1058	Inlay aneXys vitamys standard 36 / G
52.34.1059	Inlay aneXys vitamys standard 36 / H
52.34.1060	Inlay aneXys vitamys standard 36 / I
52.34.1061	Inlay aneXys vitamys standard 36 / J
52.34.1062	Inlay aneXys vitamys standard 36 / K
52.34.1063	Inlay aneXys vitamys standard 36 / L
52.34.1064	Inlay aneXys vitamys standard 36 / M

Materiali: HXLPE e stabilizuar me vitaminë E



Inlay aneXys vitamys i ngritur

Nr. i artikullit	Përshkrimi
52.34.1065	Inlay aneXys vitamys i ngritur 22,2/ A
52.34.1066	Inlay aneXys vitamys i ngritur 22,2/ B
52.34.1067	Inlay aneXys vitamys i ngritur 22,2/ C
52.34.1068	Inlay aneXys vitamys i ngritur 28/ C
52.34.1069	Inlay aneXys vitamys i ngritur 28/ D
52.34.1070	Inlay aneXys vitamys i ngritur 28/ E
52.34.1071	Inlay aneXys vitamys i ngritur 28/ F
52.34.1072	Inlay aneXys vitamys i ngritur 28/ G
52.34.1073	Inlay aneXys vitamys i ngritur 28/ H
52.34.1074	Inlay aneXys vitamys i ngritur 28/ I
52.34.1075	Inlay aneXys vitamys i ngritur 32/ E
52.34.1076	Inlay aneXys vitamys i ngritur 32/ F
52.34.1077	Inlay aneXys vitamys i ngritur 32/ G
52.34.1078	Inlay aneXys vitamys i ngritur 32/ H
52.34.1079	Inlay aneXys vitamys i ngritur 32/ I
52.34.1080	Inlay aneXys vitamys i ngritur 32/ J
52.34.1081	Inlay aneXys vitamys i ngritur 32/ K
52.34.1082	Inlay aneXys vitamys i ngritur 32/ L
52.34.1083	Inlay aneXys vitamys i ngritur 32/ M
52.34.1084	Inlay aneXys vitamys i ngritur 36/ G
52.34.1085	Inlay aneXys vitamys i ngritur 36/ H
52.34.1086	Inlay aneXys vitamys i ngritur 36/ I
52.34.1087	Inlay aneXys vitamys i ngritur 36/ J
52.34.1088	Inlay aneXys vitamys i ngritur 36/ K
52.34.1089	Inlay aneXys vitamys i ngritur 36/ L
52.34.1090	Inlay aneXys vitamys i ngritur 36/ M

Materiali: HXLPE e stabilizuar me vitaminë E



Inlay aneXys ceramys*

Nr. i artikullit	Përshkrimi
52.34.1143	Inlay aneXys ceramys 28/C
52.34.1144	Inlay aneXys ceramys 28/D
52.34.1145	Inlay aneXys ceramys 32/E
52.34.1146	Inlay aneXys ceramys 32/F
52.34.1147	Inlay aneXys ceramys 32/G
52.34.1148	Inlay aneXys ceramys 32/H
52.34.1149	Inlay aneXys ceramys 32/I
52.34.1150	Inlay aneXys ceramys 32/J
52.34.1151	Inlay aneXys ceramys 32/K
52.34.1152	Inlay aneXys ceramys 36/G
52.34.1153	Inlay aneXys ceramys 36/H
52.34.1154	Inlay aneXys ceramys 36/I
52.34.1155	Inlay aneXys ceramys 36/J
52.34.1156	Inlay aneXys ceramys 36/K

Materiali: $\text{ZrO}_2\text{-Al}_2\text{O}_3$

* Për përdorim vetëm me kokat femorale qeramike të Mathys.

Kësula polare aneXys



Nr. i artikullit	Përshkrimi
52.34.1038	Kësulë polare aneXys

Materiali: Ti6Al4V

Vidha e kockës sfungjerore aneXys TAV



Nr. i artikullit	Përshkrimi
52.34.1106	Vidhë e kockës sfungj. aneXys TAV 6,5 x 16
52.34.1107	Vidhë e kockës sfungj. aneXys TAV 6,5 x 20
52.34.1108	Vidhë e kockës sfungj. aneXys TAV 6,5 x 24
52.34.1109	Vidhë e kockës sfungj. aneXys TAV 6,5 x 28
52.34.1110	Vidhë e kockës sfungj. aneXys TAV 6,5 x 32
52.34.1111	Vidhë e kockës sfungj. aneXys TAV 6,5 x 36
52.34.1112	Vidhë e kockës sfungj. aneXys TAV 6,5 x 40
52.34.1113	Vidhë e kockës sfungj. aneXys TAV 6,5 x 44
52.34.1114	Vidhë e kockës sfungj. aneXys TAV 6,5 x 48
52.34.1115	Vidhë e kockës sfungj. aneXys TAV 6,5 x 52
52.34.1116	Vidhë e kockës sfungj. aneXys TAV 6,5 x 56
52.34.1117	Vidhë e kockës sfungj. aneXys TAV 6,5 x 60
52.34.1118	Vidhë e kockës sfungj. aneXys TAV 6,5 x 64
52.34.1119	Vidhë e kockës sfungj. aneXys TAV 6,5 x 68


Materiali: Ti6Al4V

Vërejtje

Implantet prej titani janë të veshura me oksid të ngjyrosur. Mund të shfaqen ndryshime të vogla të ngjyrës, por që nuk ndikojnë në cilësinë e implantit.

5. Instruments

5.1 Kompleti i instrumenteve aneXys 51.34.1020A



Nr. i artikullit 51.34.1021 **Tabaka e thjeshtë aneXys**

Nuk ka fotografi / Nr. i artikullit 51.34.1023 **Kapak tabakaje**



Instrumentet standarde

Nr. i artikullit	Përshkrimi
51.34.0931	Impaktor i drejtë i folesë M8x1 i shkurt.
51.34.0930	Impaktor i drejtë i folesë M8x1 i gjatë (opsional)

Nr. i artikullit	Përshkrimi
51.34.0932	Impaktor i lakuar i folesë M8x1

Nr. i artikullit	Përshkrimi
51.34.0933	Pllakë për rrotullim dhe ekstraktim

Nr. i artikullit	Përshkrimi
51.34.0936	Vendosës i lakuar i tapës polare

Nr. i artikullit	Përshkrimi
51.34.0937	Kaçavidë heks. 4,5 mm

Nr. i artikullit	Përshkrimi
51.34.0947	Kokë prej poliamidi 22,2 mm
51.34.0948	Kokë prej poliamidi 28 mm
51.34.0949	Kokë prej poliamidi 32 mm
51.34.0950	Kokë prej poliamidi 36 mm

Nr. i artikullit	Përshkrimi
51.34.0934	Udhëzues pozicionimi për shtr. në shpinë

Nr. i artikullit	Përshkrimi
51.34.0935	Udhëzues pozicionimi lateral

Moduli shtesë: **Moduli i kupave të provës**




Nr. i artikullit 51.34.1024 **Shtesë modulare për kupat e provës**



Nr. i artikullit	Përshkrimi
51.34.0951 *	Fole prove 40 mm
51.34.0952	Fole prove 42 mm
51.34.0953	Fole prove 44 mm
51.34.0954	Fole prove 46 mm
51.34.0955	Fole prove 48 mm
51.34.0956	Fole prove 50 mm
51.34.0957	Fole prove 52 mm
51.34.0958	Fole prove 54 mm
51.34.0959	Fole prove 56 mm
51.34.0960	Fole prove 58 mm
51.34.0961	Fole prove 60 mm
51.34.0962	Fole prove 62 mm
51.34.0963	Fole prove 64 mm
51.34.0964 *	Fole prove 66 mm
51.34.0965 *	Fole prove 68 mm
51.34.0966 *	Fole prove 70 mm

* Opsional

Moduli shtesë: **Moduli i inlay-eve të provës**



Nr. i artikullit 51.34.1025 **Shtesë modulare për inlay-et e provës**




Nr. i artikullit	Përshkrimi
51.34.1047	Forceps për heqjen e inlay të provës

Nr. i artikullit	Përshkrimi
51.34.0967	Inlay prove standard 22,2/ A
51.34.0968	Inlay prove standard 22,2/ B
51.34.0969	Inlay prove standard 22,2/ C
51.34.0970	Inlay prove standard 28/ C
51.34.0971	Inlay prove standard 28/ D
51.34.0972	Inlay prove standard 28/ E
51.34.0973	Inlay prove standard 28/ F
51.34.0974	Inlay prove standard 28/ G
51.34.0975	Inlay prove standard 28/ H
51.34.0976	Inlay prove standard 28/ I
51.34.0977	Inlay prove standard 32/ E
51.34.0978	Inlay prove standard 32/ F
51.34.0979	Inlay prove standard 32/ G
51.34.0980	Inlay prove standard 32/ H
51.34.0981	Inlay prove standard 32/ I
51.34.0982	Inlay prove standard 32/ J
51.34.0983	Inlay prove standard 32/ K
51.34.0984	Inlay prove standard 32/ L
51.34.0985	Inlay prove standard 32/ M
51.34.0986	Inlay prove standard 36/ G
51.34.0987	Inlay prove standard 36/ H
51.34.0988	Inlay prove standard 36/ I
51.34.0989	Inlay prove standard 36/ J
51.34.0990	Inlay prove standard 36/ K
51.34.0991	Inlay prove standard 36/ L
51.34.0992	Inlay prove standard 36/ M



Nr. i artikullit	Përshkrimi
51.34.0993	Inlay prove i ngritur 22,2/ A
51.34.0994	Inlay prove i ngritur 22,2/ B
51.34.0995	Inlay prove i ngritur 22,2/ C
51.34.0996	Inlay prove i ngritur 28/ C
51.34.0997	Inlay prove i ngritur 28/ D
51.34.0998	Inlay prove i ngritur 28/ E
51.34.0999	Inlay prove i ngritur 28/ F
51.34.1000	Inlay prove i ngritur 28/ G
51.34.1001	Inlay prove i ngritur 28/ H
51.34.1002	Inlay prove i ngritur 28/ I
51.34.1003	Inlay prove i ngritur 32/ E
51.34.1004	Inlay prove i ngritur 32/ F
51.34.1005	Inlay prove i ngritur 32/ G
51.34.1006	Inlay prove i ngritur 32/ H
51.34.1007	Inlay prove i ngritur 32/ I
51.34.1008	Inlay prove i ngritur 32/ J
51.34.1009	Inlay prove i ngritur 32/ K
51.34.1010	Inlay prove i ngritur 32/ L
51.34.1011	Inlay prove i ngritur 32/ M
51.34.1012	Inlay prove i ngritur 36/ G
51.34.1013	Inlay prove i ngritur 36/ H
51.34.1014	Inlay prove i ngritur 36/ I
51.34.1015	Inlay prove i ngritur 36/ J
51.34.1016	Inlay prove i ngritur 36/ K
51.34.1017	Inlay prove i ngritur 36/ L
51.34.1018	Inlay prove i ngritur 36/ M

Moduli shtesë: **Moduli i fiksimit të vidhave** (opsional)



Nr. i artikullit 51.34.1026 **Shtesë modulare për fiksimin e vidhave**



Nr. i artikullit	Përshkrimi
51.34.0938	Udhëzues i drejtë shpimi 3,2 mm
51.34.1048	Udhëzues shpimi 4,0 mm i drejtë



Nr. i artikullit	Përshkrimi
51.34.0939	Udhëzues i lakuar shpimi 3,2 mm
51.34.1049	Udhëzues shpimi 4,0 mm i lakuar



Nr. i artikullit	Përshkrimi
51.34.0940	Bosht i përkulshëm për punto



Nr. i artikullit	Përshkrimi
51.34.1052	Puntot 3,2x20
51.34.0941	Puntot 3,2x32
51.34.0942	Puntot 3,2x44
51.34.1050	Puntot 4,0x20
51.34.1051	Puntot 4,0x32



Nr. i artikullit	Përshkrimi
51.34.0943	Matës thellësie



Nr. i artikullit	Përshkrimi
51.34.0944	Forceps i drejtë për mbajtjen e vidhave




Nr. i artikullit	Përshkrimi
51.34.0945	Forceps i lakuar për mbajtjen e vidhave



Nr. i artikullit	Përshkrimi
51.34.0946	Kaçavidë heks. me kardan 3,5 mm

Moduli shtesë: **Heqja e inlay-it qeramik** (opsionale)



Nr. i artikullit 51.34.1027 **Shtesë mod. për heqjen e inlay qeramik**



Nr. i artikullit	Përshkrimi
51.34.1034	Ekstraktor universal për inlay qeramik


Nr. i artikullit	Përshkrimi
51.34.1035	Majë për heqjen e inlay qeramik 44/C
51.34.1036	Majë për heqjen e inlay qeramik 46/D
51.34.1037	Majë për heqjen e inlay qeramik 48/E
51.34.1038	Majë për heqjen e inlay qeramik 50/F
51.34.1039	Majë për heqjen e inlay qeramik 52/G
51.34.1040	Majë për heqjen e inlay qeramik 54/H
51.34.1041	Majë për heqjen e inlay qeramik 56/I
51.34.1042	Majë për heqjen e inlay qeramik 58–62/J
51.34.1043	Majë për heqjen e inlay qeramik 64–70/K

Nr. i artikullit	Përshkrimi
51.34.1044	Kokë për heqjen e inlay qeramik 28 mm
51.34.1045	Kokë për heqjen e inlay qeramik 32 mm
51.34.1046	Kokë për heqjen e inlay qeramik 36 mm

Tabakatë modulare (optionale)

Nr. i artikullit	Përshkrimi
51.34.1022	Tabaka bosh për shtesat modulare
51.34.1028	Shtesë modulare e madhe bosh
51.34.1029	Mbulesë silikonit e shtesës mod. të madhe
51.34.1030	Shtesë modulare e vogël bosh
51.34.1031	Mbulesë silikonit e shtesës mod. të vogël

Instrumente të frezës acetabulare, 51.34.1081A



Frezat acetabulare, masat çift

Nr. i artikullit	Përshkrimi
51.34.0360	Tabaka për freza acetabulare tek
51.34.0679	Kapak për tabaka frezash acetabulare



Nr. i artikullit	Përshkrimi
5440.00.5	Frezë acetabulare 40 stand.
5442.00.5	Frezë acetabulare 42 stand.
5444.00.5	Frezë acetabulare 44 stand.
5446.00.5	Frezë acetabulare 46 stand.
5448.00.5	Frezë acetabulare 48 stand.
5450.00.5	Frezë acetabulare 50 stand.
5452.00.5	Frezë acetabulare 52 stand.
5454.00.5	Frezë acetabulare 54 stand.
5456.00.5	Frezë acetabulare 56 stand.
5458.00.5	Frezë acetabulare 58 stand.
5460.00.5	Frezë acetabulare 60 stand.
5462.00.5	Frezë acetabulare 62 stand.
5464.00.5	Frezë acetabulare 64 stand.
5466.00.5	Frezë acetabulare 66 stand.
5468.00.5	Frezë acetabulare 68 stand.
5470.00.5	Frezë acetabulare 70 stand.
5472.00.5	Frezë acetabulare 72 stand.

Frezat acetabulare, masat tek

Nr. i artikullit	Përshkrimi
51.34.0361	Tabaka për freza acetabulare çift
51.34.0679	Kapak për tabaka frezash acetabulare



Nr. i artikullit	Përshkrimi
5439.00.5	Frezë acetabulare 39 stand.
5441.00.5	Frezë acetabulare 41 stand.
5443.00.5	Frezë acetabulare 43 stand.
5445.00.5	Frezë acetabulare 45 stand.
5447.00.5	Frezë acetabulare 47 stand.
5449.00.5	Frezë acetabulare 49 stand.
5451.00.5	Frezë acetabulare 51 stand.
5453.00.5	Frezë acetabulare 53 stand.
5455.00.5	Frezë acetabulare 55 stand.
5457.00.5	Frezë acetabulare 57 stand.
5459.00.5	Frezë acetabulare 59 stand.
5461.00.5	Frezë acetabulare 61 stand.
5463.00.5	Frezë acetabulare 63 stand.
5465.00.5	Frezë acetabulare 65 stand.
5467.00.5	Frezë acetabulare 67 stand.
5469.00.5	Frezë acetabulare 69 stand.
5471.00.5	Frezë acetabulare 71 stand.



Frezat acetabulare

Nr. i artikullit	Përshkrimi
58.02.4008	Dorezë me çiftim të shpejtë

Nr. i artikullit	Përshkrimi
5244.00.4	Përshtatës për frezë (AO)

Instrumentet opsionale (nuk bëjnë pjesë në komplet)



Lidhja e frezës së mbyllur

Nr. i artikullit	Përshkrimi
H0032100699	MIS HANDLE ATTACCO UNIVERSALE-CONN. AO

Lidhja e frezës së hapur

Nr. i artikullit	Përshkrimi
H0032100999	MIS HANDLE HC- CONN. AO




Nr. i artikullit	Përshkrimi
3.40.535	Mandrinë për trapan me ajër AO-ASIF



Nr. i artikullit	Përshkrimi
999-0060-300	Mandrinë për motor Hudson

5.2 Shablloni matës



Nr. i artikullit	Përshkrimi
330.010.102	aneXys Cup

6. Referencat

- 1 Learmonth, I. D., Young, C. and Rorabeck, C. The operation of the century: total hip replacement. Lancet. 370(9597), 2007, pp. 1508-1519.
- 2 Pivec, R., et al. Hip arthroplasty. Lancet. 380(9855), 2012, pp. 1768-1777.
- 3 Data on file at Mathys Ltd Bettlach
- 4 Girard, J. Femoral head diameter considerations for primary total hip arthroplasty. Orthopaedics & Traumatology: Surgery & Research. 101, 2015, pp. 25-29.
- 5 Begand, S., Oberbach, T. and Glien, W. Corrosion Behaviour of ATZ and ZTA Ceramic. Key Eng Mater. 330-332, 2007, pp. 1227-1230.
- 6 Al-Hajjar, M., et al. Wear of novel ceramic-on-ceramic bearings under adverse and clinically relevant hip simulator conditions. J Biomed Mater Res B Appl Biomater. 101(8), 2013, pp. 1456-1462.
- 7 Halma, J.J., et al. Edge loading does not increase wear rates of ceramic-on-ceramic and metal-on-polyethylene articulations. J Biomed Mater Res B Appl Biomater. 102(8), 2014, pp. 1627-1638.
- 8 Scheerlinck, T. Primary hip arthroplasty templating on standard radiographs. A stepwise approach. Acta Orthop Belg. 76(4), 2010, pp. 432-442.
- 9 Wasielewski, RC, et al. Acetabular anatomy and the transacetabular fixation of screws in total hip arthroplasty. J Bone Joint Surg Am. 72(4), Apr 1990, pp. 501-508.
- 10 Ezzet, KA and McCauley, JC. Use of Intraoperative X-rays to Optimize Component Position and Leg Length During Total Hip Arthroplasty. The Journal of Arthroplasty. 29(3), 2014, pp. 580-585.
- 11 Walmsley, D. W., J. P. Waddell and E. H. Schemitsch. Isolated Head and Liner Exchange in Revision Hip Arthroplasty. J Am Acad Orthop Surg 25, no. 4. 2017. pp 288-296.

7. Simbolet



Prodhuesi



Kujdes

Australia	Mathys Orthopaedics Pty Ltd Lane Cove West, NSW 2066 Tel: +61 2 9417 9200 info.au@mathysmedical.com	Italy	Mathys Ortopedia S.r.l. 20141 Milan Tel: +39 02 4959 8085 info.it@mathysmedical.com
Austria	Mathys Orthopädie GmbH 2351 Wiener Neudorf Tel: +43 2236 860 999 info.at@mathysmedical.com	Japan	Mathys KK Tokyo 108-0075 Tel: +81 3 3474 6900 info.jp@mathysmedical.com
Belgium	Mathys Orthopaedics Belux N.V.-S.A. 3001 Leuven Tel: +32 16 38 81 20 info.be@mathysmedical.com	New Zealand	Mathys Ltd. Auckland Tel: +64 9 478 39 00 info.nz@mathysmedical.com
France	Mathys Orthopédie S.A.S 63360 Gerzat Tel: +33 4 73 23 95 95 info.fr@mathysmedical.com	Netherlands	Mathys Orthopaedics B.V. 3001 Leuven Tel: +31 88 1300 500 info.nl@mathysmedical.com
Germany	Mathys Orthopädie GmbH «Centre of Excellence Sales» Bochum 44809 Bochum Tel: +49 234 588 59 0 sales.de@mathysmedical.com «Centre of Excellence Ceramics» Mörsdorf 07646 Mörsdorf/Thür. Tel: +49 364 284 94 0 info.de@mathysmedical.com «Centre of Excellence Production» Hermsdorf 07629 Hermsdorf Tel: +49 364 284 94 110 info.de@mathysmedical.com	P. R. China	Mathys (Shanghai) Medical Device Trading Co., Ltd Shanghai, 200041 Tel: +86 21 6170 2655 info.cn@mathysmedical.com
		Switzerland	Mathys (Schweiz) GmbH 2544 Bettlach Tel: +41 32 644 1 458 info@mathysmedical.com
		United Kingdom	Mathys Orthopaedics Ltd Alton, Hampshire GU34 2QL Tel: +44 8450 580 938 info.uk@mathysmedical.com

Local Marketing Partners in over 30 countries worldwide ...

